Drive

PORSCHE
ALBANIA

12/13

Mirë se vini në “Business Class”

Welcome to “Business Class”

F/Pg. 14

Rritemi dhe ecim më shpejt

Getting bigger, moving faster

F/Pg. 4

2014 Viti i kthesës

2014The year of change

F/Pg. 6

Në ajër

In the air

F/Pg. 12

Drive 12/13

with us

14

Përmbajtja - Contents

- **03** **I DASHUR LEXUES** - DEAR READER
- **04** **RRITEMI DHE ECIM MË SHPEJT** - GETTING BIGGER, MOVING FASTER
- **06** **2014 VITI I KTHESËS** - 2014 THE YEAR OF CHANGE
- **10** **NË AJËR** - IN THE AIR
- **12** **MERRNI MAKINËN QË DËSHIRONI** - GET THE CAR EASILY
- **14** **MIRË SE VINI NË "BUSINESS CLASS"** - **WELCOME TO "BUSINESS CLASS"**
- **16** **GOLF, NJË VARIANT INTERESANT** - GOLF, AN INTERESTING VARIANT
- **21** **CAR MYTHS**
- **20** **THE HYBRID FUTURE** - E ARDHMJA E MAKINAVE HIBRIDE
- **21** **DAS WELTAUTO**
- **22** **SEAT AL SOL**
- **23** **SEAT IBIZA CUPRA**
- **24** **8 VJET NË LËVIZJE** - 8 YEARS ONTHE MOVE
- **26** **PANAIRI KLIK EXPO - KLIK EXPO TRADE FAIR**

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.

Realizimi: Botues Porsche Albania, Realizimi grafik: Euro RSCG Tirana, Albania.

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com,
SEAT: media.seat.com,
VW Makina Tregtare: volkswagen-media-services.com, VW Das Auto Magazine
Skoda: press.skoda-auto.com.

Për komente, pyetje apo sygjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania,
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 3, Mëzez.
Telefon: +355 (04) 240 74 30 , Fax.: +355 (04) 240 74 34,
e-mail: office@porsche.al; http://www.porsche.al

I dashur lexues,

Ja ku takohemi përsëri në numrin e fundvitit të revistës “Drive” për të parë dhe për të ndarë me ju ecurinë tonë, problemet e tregut ku ne veprojmë, kuriozitetet apo edhe të rejat më të fundit të markave që ne përfaqësojmë në tregun shqiptar.

Një gjashtëmujor ky i mbushur me aktivitete, sfida dhe arritje për Porsche Albania. Në tetor kemi festuar 8 vjetorin e hyrjes në tregun shqiptar, një aktivitet i cili na sjell pothuajse çdo vit në qendër të Tiranës për t’u takuar me klientët, miqtë apo bashkëpunëtorët tanë.

Në nëntor, në edicionin e përvitshëm të panairit Klik Ekspo ne arritëm të sillnim për herë të parë në Shqipëri 4 modele tërësisht të reja: Audi A3 Sedan, SKODASuperb dhe SKODAYeti. Ofensiva e modeleve të reja do të vazhdojë edhe në fillim të vitit 2014 me disa modele surprizë.

Në këta gjashtë muaj kemi parë protesta si ajo kundër importit të armëve apo agjentëve kimikë nga Siria, kemi festuar së bashku 101 vjetorin e pavarësisë, jemi përballur por edhe kemi marrë pjesë në debatin mbi efektet që kanë në mjedis makina të vjetra në Shqipëri, kemi lobuar për të përmirësuar legjislacionin për një mjedis më të mirë dhe një jetë më të shëndetshme, si edhe shumë aktivitete të tjera mbi të cilat do të keni mundësi të lexoni në faqet në vijim.

Lexim të mbarë.

Dorian Mehmeti

Drejtor Marketingu, Porsche Albania.

Dear Reader,

Here we meet again in the end-of-year edition of Drive magazine, to review and share with you our progress, issues related to the market we operate in, curiosities or even the latest news on the brands we represent in the Albanian market.

These have been six months full of events, challenges and achievements for Porsche Albania. In October we celebrated the 8th anniversary of our entry in the Albanian market, an event which brings us almost every year at the centre of Tirana to meet with our customers, friends or partners.

In November, during the annual edition of Klik Expo fair we succeeded in bringing for the first time in Albania 4 brand new models: Audi A3 Sedan, SKODA Superb and SKODA Yeti. The new model offensive will continue at the beginning of 2014 with some surprise models.

During these six months we have witnessed protests such as that against the import of chemical weapons or substances from Syria, we celebrated together the 101st anniversary of Independence, we have dealt with and participated in the debate on environmental impact of old cars in Albania, we have lobbied to improve the legislation for a cleaner environment and healthier life, and many other events, which you may read about in the following pages.

Enjoy the reading.

Dorian Mehmeti

Marketing Director, Porsche Albania.

Rritemi dhe ecim më shpejt
Getting bigger, moving faster

Porsche Holding Salzburg zgjeron Qendrën për Pjesët e Këmbimit

Në mes të Tetorit, në prani të Dr. Wilfried Haslauer (Guvernator i Landit të Salzburgut) dhe Joachim Maislinger (Kryetar i bashkisë së Wals-Siezenheim), u bë përurimi i fillimit të punimeve për zgjerimin e Qendrës së Pjesëve të Këmbimit të Porsche Holding (TVZ) në Wals-Siezenheim.

"TVZ, e cila është themeluar në vitin 1984, është platforma logjistike për shpërndarjen e pjesëve origjinale të këmbimit të markave të grupit Volkswagen në Austri dhe Evropën Lindore. Qendra jonë e logjistikës dallohet për cilësinë e lartë të shërbimeve dhe përpikmërinë", - tha Alain Favey, Drejtor Ekzekutiv i Porsche Holding Salzburg.

Ndërtimi i ri për zgjerimin e hapësirave të zyrave dhe magazinave do të plotësojë nevojat e kompleksitetit në rritje të pjesëve. Kjo sepse nismat e modeleve të markave të grupit (veturat dhe makinat tregtare Volkswagen, Audi, SEAT, ŠKODA dhe Porsche) do të sjellin një gamë më të madhe produktesh dhe një shumëllojshmëri pjesësh këmbimi. Për këtë arsye pritet të rriten ndjeshëm kërkesat për stok.
TVZ aktualisht ka 347 punonjës të cilët vijnë kryesisht nga zonat përreth. Kjo e bën Qendrën e Pjesëve të Këmbimit një nga punëdhënësit më të mëdhenj në rajon. Realizimi i këtij investimi të rëndësishëm siguron të ardhmen e zonës Wals-Siezenheim. Përveç kësaj, projekti nxit zhvillimin e mëtejshëm dhe në këtë mënyrë hap edhe 30 vende të reja pune.
Qendra e Pjesëve të Këmbimit tërësisht e modernizuar, me një sipërfaqe totale magazinimi prej 77 000 m² pritet të përfundojë në fund të vitit 2015. Vlera e investimit prek shumën 31 milion euro.
Ky zgjerim do të ketë ndikim pozitiv për Shqipërinë, në lidhje me kohën e porositjes së pjesëve të këmbimit. Falë rritjes së kapaciteteve, pjesët e këmbimit që më parë porositeshin nga stoku i fabrikës, do të shpërndahen më shpejt përmes kanaleve të kompanisë për porositjen e pjesëve të këmbimit.

Porsche Holding Salzburg to Expand Spare Parts Centre

In the presence of Dr. WilfriedHaslauer (Governor of the Land of Salzburg) and Joachim Maislinger (Mayor of the Municipality of Wals-Siezenheim), the first sod for the expansion site of Porsche Holding's Spare Parts Centre (TVZ) in Wals-Siezenheim was turned in mid October 2013.

"The TVZ, which was established in 1984, is the logistics platform for the distribution of original spare parts to the Volkswagen Group brands in Austria and Eastern Europe", says Alain Favey, CEO of Porsche Holding Salzburg, "Our logistics competence center distinguishes itself through its high service quality and promptness".

The upcoming construction to expand the office and storage space will meet the needs of an increasing complexity of parts. For the model initiatives of the Group brands (Volkswagen Passenger Cars and Commercial Vehicles, Audi, SEAT, ŠKODA and Porsche) will entail an increased range of products and a diversification of spare parts. Therefore, considerably increasing stock requirements are to be expected.

The TVZ currently has 347 employees who mainly come from the surrounding areas. This makes the Spare Parts Centre one of the largest employers in the region. The realization of this substantial investment secures the future of the site in Wals-Siezenheim. Moreover, the project initiates further growth and, thus, also creates about 30 new jobs.

The entirely modernized Spare Parts Centre, then having a total storage space of 77,000 m², is to be completed by the end of 2015. The investmentvolume amounts to 31 million Euros.

This expansion will have a positive impact in terms of spare parts ordering time for Albania. Due to larger capacities, spare parts that were previously ordered from the factory stock will be allocated faster through the company spare parts ordering channels.

Shifrat kryesore të TVZ

- Sipërfaqja aktuale e magazinimit: 56 000 m² për afërsisht 116 000 pjesë këmbimi
- Pas zgjerimit, sipërfaqja e magazinimit do të rritet në 77 000 m², që do të thotë aq e madhe sa 11 fusha futbolli.
- Rreth 27 000 pjesë këmbimi dërgohen çdo ditë tek shpërndarësit në Austri dhe në tregjet e "Porsche" në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore.
- 135 000 artikuj porositen çdo javë.
- Aktualisht pranë TVZ-së mund të porositen 890 000 pjesë këmbimi. Parashikohet që në vitin 2020 ky numër të arrijë në 1,1 milion artikuj.
- Duhet pak më shumë se gjysmë dite për të dërguar pjesën e nevojshme të këmbimit te një shpërndarës në Austri. Kushinetat me sfera, freksionet etj. arrijnë në vendet fqinje të Austrisë brenda njëzet orëve.

TVZ Key Figures

- Current storage space: 56,000 m² for approx. 116,000 spare parts
- After the expansion, the storage space increases to 77,000 m². This is as big as 11 football fields.
- Approximately 27,000 spare parts items are shipped daily to the dealerships in Austria and to the "Porsche" markets in the CEE countries.
- 135,000 items are ordered each week.
- Currently, 890,000 spare parts can be ordered with the TVZ. For 2020, the forecast is 1.1 million items.
- It only takes little more than half a day to have the required spare part available at a dealership in Austria. Ball bearings, clutches, etc. reach Austria's neighboring countries in less than twenty hours.

SIMPLY CLEVER

ŠKODA

Konsumi i kombinuar i karburantit dhe emetimet e kombinuara të CO2 për Superb janë: 4.2-9.3 l/100 km, 109-217 g/km.

Ne shpenzojmë një pjesë të mirë të ditës në makinë: duke pritur familjarët apo miqtë, në trafik, në semafor apo duke udhëtuar. A nuk do të ishte më mirë që këtë kohë ta kalonim në një makinë me hapësirë të bollshme, komode, të sigurtë dhe efiçente?! Një makinë që vjen nga përvoja më e mirë e grupit Volkswagen dhe sjell hapësirën më të madhe në brendësi në kategorinë e vet! Zgjero hapësirën dhe zgjidh rrugën tënde! Të mjafton vetëm një telefonatë në sallonin ŠKODA apo vizitë në www.skoda-auto.al për të caktuar një xhiro prove me ŠKODA Superb.und t'ju flasin gjatë për besueshmërinë e kësaj marke. **Ne ju themi shkurt: ejani ta provoni!**

www.skoda-auto.al

facebook.al/skodaalb

Për më tepër na vizitoni në tre sallonet tona:

PORSCHE
ALBANIA
Autostrada Tiranë-Durrës km. 3, Tiranë,
Cel: +355 (0) 69 20 75 288,
E.: info@skoda-auto.al, www.skoda-auto.al.

E.T.T Group Auto Sh.p.k
Kthesa e Viroit, Gjirokastër
Cel.: +355 (0) 69 40 52 594
E.: ettgroupauto@gmail.com

KOSTANDIN GROUP
Rruga Nacionale Shkodër-Tiranë
Cel.: +355 (0) 69 40 89 491
E.: info@kostandingroup.com

2014
Viti i kthesës
The year of change

Gentian Bushati & Fabian Jungnitsch
Drejtorë të Përgjithshëm të Porsche Albania / General Managers at Porsche Albania

Intervistë me Gentian Bushatin dhe Fabian Jungnitsch Drejtorë të Përgjitshëm në Porsche Albania.

Interview with Gentian Bushati and Fabian Jungnitsch, General Managers at Porsche Albania.

I. Z. Bushati po e filloj këtë intervistë me ju. Jemi në numrin e fundit të revistës Drive për këtë vit. Si do ta vlerësonit 2013-ën?

Ky vit ishte tepër i vështirë për sa i përket industrisë automobilistike, veçanërisht për segmentin e makinave të reja. Ky vit ka njohur përsëri rënie krahasuar me vitin paraardhës dhe sipas shifrave paraprake kjo rënie është rreth 15%. Impaktin më të madh kjo rënie e ka pasur në tregun e makinave tregtare. Tregu i makinave të përdorura, do të thosha se është në të njëjtin nivel me atë të vitit 2012, pra rreth 50,000 makina. Ashtu siç edhe e kemi përmendur më parë, një ndikim negativ ka pasur pa dyshim edhe ndryshimi i ligjit në shtator të vitit 2011, si dhe kriza ekonomike e cila u thellua si në rajonin tonë, ashtu edhe në Shqipëri.

Për t'u theksuar është edhe riorganizimi dhe funksionimi i shoqatës së distributorëve të makinave të reja, e cila ka qenë një zë i fortë në takimet me grupet e interesit për modernizimin e legjislacionit mbi tregun e makinave të përdorura.

Takimet që u zhvilluan ndërmjet Shoqatës së Koncesionarëve me Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Transporteve dhe në grupet parlamentare shpresojmë të jenë frutdhënës në mënyrë që tregu automobilistik shqiptar të shkojë drejt një procesi formalizimi dhe modernizimi në funksion të sigurisë së jetës dhe mjedisit. Për këto takime gjej rastin të përshëndes e të falënderoj të gjithë ministrat dhe deputetët e Kuvendit të Shqipërisë të angazhuar në këto takime.

Ne mbetemi shpresëplotë se qeveria e re do të marrë në konsideratë sugjerimet për ndryshime në legjislacion dhe faktet që ne kemi parashtruar në mënyrë që publiku të ketë pranë gjithmonë produkte të garantuara si nga siguria, ashtu edhe për sa i përket ndotjes brenda kufijve të lejuar në mënyrë që të kemi një jetë më të mirë e më të sigurtë për qytetarët e këtij vendi.

I. Mr. Bushati I will start with you. We are at the yearend edition of the Drive Magazine. How would you define 2013?

It was an extremely challenging year in the automotive industry, specifically concerning the new cars segment. This year has again experienced a decline compared to the previous year, referring to the preliminary figures this decline stands at approx. 15%. The greatest impact of this decline has been in the commercial vehicles market. I would say that the used cars market is similar to that 2012, with about 50,000 units. As already mentioned in our June edition of Drive magazine, the amendment of the law in September 2011 and the global economic crisis, which deepened both in our region and throughout Albania, undoubtedly have had a negative impact.

It is noteworthy that the new cars distributors association was reorganized and has been a strong voice in meetings with stakeholders for the modernization of the legislation on the used cars market.

We hope that the meetings that were held between the Association of Concessionaires and the Ministry of Economy, Ministry of Transports and the parliamentary groups were fruitful so that the Albanian car market can move toward a formalization and modernization process in terms of minimizing the environmental impact and address the safety issues. Concerning these meetings, I take this opportunity to greet and thank all of the ministers and deputies of the Parliament that have been part of this process.

We remain hopeful that the new government will consider the suggestions on amendments to the legislation and the facts submitted by us so that the public can have access to qualitative products, both in terms of safety and emission standards being within the permitted levels in order to have a better and safer life for the citizens of this country.

I. Cilat ishin risitë e makave tuaja?

Porsche Albania këtë vit erdhi me disa produkte të reja në treg dhe këto dhanë një kontribut të rëndësishëm që ne të kishim një rezultat të kënaqshëm në raport me pjesën përkatëse të këtyre markave në treg. Këtu vlen të përmenden disa nga modelet e reja siç janë A8 e ristilizuar, Audi A3 Sedan, VW UP dhe VW Golf, SEAT Leon ST, ŠKODA Rapid, ŠKODA Yeti e ristilizuar, ŠKODA Octavia e re dhe ŠKODA Superb e ristilizuar. Këto modele u sollën për herë të parë në tregun shqiptar nga Porsche Albania dhe distributorët tanë në rrethe.

I. Z. Jungnitsch, tregu i makinave të reja është lëkundur fort këtë vit. Si do ta konsideronit departamentin e servisit në këtë treg?

Departamenti i servisit në Porsche Albania ka qënë ndër vite një pjesë e rëndësishme e kompanisë dhe roli i këtij departamenti bëhet thelbësor në kohë krize ku shitja e makinave të reja ka pësuar rënie. Për 2013-ën ekipi i servisit ka arritur sërisht të realizojë 100% objektivat e vendosura si edhe të pozicionohet si një ndër serviset me performancën më të lartë në Shqipëri. Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë nivelin e shërbimit për klientët tanë dhe jemi shumë mirënjohës për përshtypjet e marra prej tyre.

I. Cili do të jetë fokusi në 2014 përsa i përket servisit dhe makinave të përdorura në Porsche Albania?

Në 2013-ën ne kemi vazhduar të investojmë në kapacitetet e servisit si edhe duke modernizuar dhe përdituar pajisjet tona si edhe duke trajnuar brenda apo edhe jashtë vendit teknikët tanë. Në vitin 2014 janë parashikuar disa investime të rëndësishme të cilat përfshijnë ngritjen e një gardhi izolues si edhe një sistem modern për përthithjen e tymrave.

Porsche Albania do të vazhdojë edhe në 2014-ën të përqëndrohet edhe në tregun e makinave të përdorura edhe pse zhvillime të rëndësishme mund të ketë vetëm pas masave të qeverisë për të formalizuar dhe ngritur në nivel profesional këtë treg. Këto masa kanë të bëjnë kryesisht me përmirësimin e legjislacionit për importin, regjistrimin si edhe taksimin e shit-blerjes në këtë treg.

I. Z. Bushati, viti 2014 po vjen. Çfarë mund të presim nga markat që ju përfaqësoni?

Në sajë të klientëve dhe bashkëpunëtorëve tanë, ne kaluam një provë të vështirë duke ndarë me ju vlerat më të mira që ofrojmë. Së bashku bëmë të mundur që të rritemi më shumë e të jemi gjithnjë e më të aftë të përmbushim nevojat tuaja në rritje.

Gjej rastin, dhe jam i bindur se dhe Ju të nderuar lexues bashkoheni me mua, për t'i falënderuar të gjithë kolegët e Porsche Albania dhe shpërndarësit tanë në rrethe për punën e palodhur e plot pasion që ata bëjnë përditë në shërbim tuaj!

Vitin që vjen 2014, Porsche Albania do të vijë me risi të tjera dhe me bindjen që kthesa e shumëpritur duhet të ndodhë në këtë vit në mënyrë që tregu automobilistik të njohë rritje në aspektin e makinave të reja të shitura në vend.

Modele të reja nga të gjitha markat që në përfaqësojmë, si Audi, Volkswagen, Volkswagen Makina Tregtare, SEAT dhe ŠKODA, do të jenë prezente në vitin 2014. Partneriteti me kompaninë simotër Porsche Leasing do të na japë mundësinë që të konceptojmë oferta sipas kërkesave dhe pritshmërive tuaja në mënyrë që t'ju ofrojmë produktet që doni me vlerën më të mirë në treg.

Për ta mbyllur, duam t'ju falënderojmë të gjithëve për besimin që na jepni dhe për sugjerimet për të përmirësuar punën tonë të përditshme për të qenë me profesionalizmin tonë edhe më afër pritshmërive tuaja në rritje.

Duam t'ju falënderojmë përzemërsisht që zgjidhni Porsche Albania dhe t'ju urojmë një vit të ri të suksesshëm.

Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri 2014!

I. What were the novelties from your brands?

Porsche Albania came this year with some new products in the market and these products gave an important contribution in order for us to reach and preserve an important part in the market share of these brands. It is also worth mentioning some of the new models such as the Audi A8 facelift, Audi A3 Sedan, VW UP and VW Golf, SEAT Leon and SEAT Leon ST, ŠKODA Rapid Spaceback, ŠKODA Yeti facelift, new ŠKODA Octavia and ŠKODA Superb facelift. These models were brought to the Albanian market by Porsche Albania and our dealer network.

I. Mr. Jungnitsch, the new car market has suffered significantly this year. How would you describe the aftersales sector in this market?

Porsche Albania aftersales Department has over the years become a vital part of our Company even more so in crises times where new car sales are decreasing. For 2013 the service team managed again to reach the targets set by almost 100% and proved to be one of the strongest performing services in Albania. We are also determined to continuously improve the services for our customers and are therefore always thankful for your valued feedback.

I. What will be the main focus for 2014 in terms of after sales and used cars at Porsche Albania?

In 2013 we have continued to invest in our service capacities by constantly modernizing and updating our tools and equipment's but also by several in-house and external product/technical trainings for our service technicians. Furthermore some considerable investments are planned in the beginning of 2014 including the installation of a new service gate and a modern exhaust suction system.

For 2014 Porsche Albania will also try to put a focus on used car sales, although this development can only be accelerated if political decisions are building a foundation to formalize and professionalize the used car business. This concerns mainly the used car import regulations, used car registration in Albania as well as taxation issues with regards to the used car purchases and sales.

I. Mr. Bushati 2014 is coming. What is to be expected from the brands that you represent?

Thanks to our customers and business partners, we passed a difficult test by sharing with you the best values that we offer. Together, we made it possible to grow further and to be increasingly more able to address your growing needs.

I would also like to seize the opportunity, and I am convinced that you dear readers shall join me, to thank all the colleagues and our dealer network for their passionate hard work performed every day in serving you!

In 2014, Porsche Albania shall come with other innovations and the belief that the long-awaited change should happen in 2014 so that the car market recognizes the growth in terms of new cars sold in the country.

New models of all the brands that we represent, such as Audi, Volkswagen, Volkswagen Commercial Vehicles, SEAT, and ŠKODA, shall be present in 2014. A partnership with our sister company Porsche Leasing will give us the opportunity to provide offers that are tailored to the customers individual requests and expectations in order to offer them the products they want with the best value in the market.

To conclude, we would like to thank you all for your confidence in us and your suggestions for the improvement of our daily work and to meet, with our professionalism, your growing expectations.

Together with my colleague Fabian Jungnitsch, we would like to cordially thank you for choosing Porsche Albania and wish you a successful year to come.

Merry Christmas and Happy New Year 2014!

PO FUNDJAVA JUAJ SI ISHTE ?

Më tepër tregime për të rrëfyer. ŠKODA Yeti e re me një dizajn mahnitës

Kur shpirti aventurier zgjohet, ju jeni gati ta ndiqni edhe mbi ujë. Pavarësisht sesa të pazakonta janë udhëtimet tuaja, ŠKODA e re Yeti me sistemin VarioFlex të palosjes së sediljeve, ju jep hapsirën e mjaftueshme dhe pajisjet e nevojshme. Riorganizoni selidjet e pasme, ulini, lëvizini apo edhe hiqini tërësisht para se të niseni. Lejoni diellin t'u udhëzojë rrugën dhe të udhëtoj me ju nëpërmjet tavanit panoramic. Dhe pas një udhëtimi të gjatë kur lodhja fillon të ndihet, Asistimi Automatik i Parkimit ju thjeshton lëvizjen e fundit të ditës. Ju duket interesante? Kontaktoni me një përfaqësues të autorizuar ŠKODA dhe përcaktoni një xhiro prove të personalizuar.

facebook.com/skodaalb

ŠKODA

Konsumi i kombinuar i karburantit dhe emetimet e kombinuara të CO2 për Yeti janë: 4.6-8 l/100 km, 119-189 g/km.

CLEVER INSIDE®

Kjo është mënyra sesi SKODA e bën më të thjeshtë jetën e përditshme të klientëve tanë.

Ndriçues LED

VarioFlex

Kosh

Tavolinë e palosëshme

Në ajër In the air

Kohët e fundit ka një interesim gjithmonë e më të madh mbi cilësinë e ajrit në Shqipëri. Për t'u dhënë përgjigje disa pyetjeve, ekipi i revistës "Drive" zhvilloi një intervistë për këtë çështje me Dr. Orion Kulo.

Recently there is a growing interest on the air quality in Albania. In order to provide answers to some of the questions, the team of "Drive" magazine conducted an interview on this issue with Dr. Orion Kulo.

I - Po flitet gjithmonë e më shumë mbi efektet në shëndet nga ndotja e ajrit. Sa serioze është situata?

Unë gjykoj që situata është serioze dhe meriton vëmendje! Cilësia e ajrit është goditur në shumë drejtime, por dy më të rëndësishmit janë ulja në masë e gjelbërimit dhe shtimi i automjeteve në qarkullim! Nëse e reduktojmë problemin në dy indikatorë, PM10 (copëza shumë të vogla që gjenden në ajër, më të vogla se 10 µm) dhe oksidi i azotit (NOx) janë çdo vit mbi vlerat e lejuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Nga studimet që janë bërë rezulton se volumi i PM10 në mëngjes e kalon me 10 herë limitin e caktuar nga OBSH-ja. Dhe sipas studimit të një kolegut tonë rezulton se në ajrin tonë shkarkohen rreth 35 000 ton "mbetje" në vit (sipas statistikave të 2003), ku çdo personi i takojnë rreth 49 kg!

Gjithashtu edhe sasia e plumbit (PB50) në ajër ka kaluar nga 0,19 µgm−3 në 0,29 µgm−3.

I - Sa ndikojnë automjetet në ndotjen e ajrit? Cilat janë efektet direkte në aparatin e frymëmarrjes dhe në mushkëri?

Ndërkohë që marrim frymë, gazet toksike dhe partikulat (mbeturinat) që prodhohen nga djegia e karburantit hyjnë në mushkëri. Duke qenë se këto copëza janë sa 1/5 e fijes se flokut të njeriut, ato arrijnë dhe depërtojnë thellë në mushkëri.

Në mushkëri depërtojnë edhe substanca të tjera, si arseniku, benzeni, formaldehidi dhe nikeli. Këto substanca mund të shkaktojnë mutacione të qelizës që mund të çojnë në kancer. Është fakt që ekspozimi për një kohë të gjatë ndaj tymit të makinave ka një lidhje të drejtpërdrejtë me probabilitetin për prekjen nga një formë tumori.

Por tymi i makinave ka edhe efekte të "menjëhershme", si p.sh. irritimi i syve, hundës, fytit dhe mushkërive. Mund të shkaktojë kollë, dhimbje koke, marrje mendsh dhe të vjella. Në studime të bëra me vullnetarë rezultoi se emetimet e motorëve diesel i kanë bërë njerëzit alergjikë edhe më të ndjeshëm ndaj alergjenëve të tyre, si pluhuri dhe lulet, si dhe kanë shtuar numrin e krizave të astmës tek personat astmatikë!

I - Cilët janë grupimet/grupmoshat më të rrezikuara?

Ekspozimi ndaj gazeve që prodhojnë motorët dhe grimcat është një sëmundje profesionale për njerëzit që janë të ekspozuar për një kohë të gjatë, si p.sh. shoferët e kamionëve, punonjësit e hekurudhave dhe minatorët. Por efekte të dëmshme mbi shëndetin janë vënë re edhe në popullsinë e përgjithshme, e cila përballet me nivele më të ulëta ndotjeje se kategoritë e sëmundjeve profesionale.

Një tjetër grup që preket nga këta faktorë ndotës janë edhe fëmijët. Mushkëritë e fëmijëve janë akoma duke u zhvilluar dhe si pasojë janë më të ndjeshme se mushkëritë e të rriturve ndaj tymit dhe grimcave të

I – More and more is being talked about air pollution impact on health. How serious is the situation?

In my opinion the situation is very serious and deserves attention! The quality of air is affected in many ways, with the two most important being the mass reduction of the green areas and the increase of the number of vehicles in circulation! If we reduce the problem into two indicators, every year, PM10 (very small particles found in the air, smaller than 10 µm) and nitrogen oxide (NOx) are above the values allowed by the World Health Organization (WHO). Studies performed have shown that the volume of PM10 in the morning exceeds the limit set by WHO by 10 times. According to the study conducted from one of our colleagues, it results that about 35,000 tons of "waste" per year are discharged in the air (as per 2003 statistics), with 49 kg belonging to each person!

Also, the amount of lead (PB50) in the air has been increased from 0.19 µgm−3 to 0.29 µgm-3.

I - How do vehicles affect the air pollution? What are the direct effects on the respiratory tract and the lungs?

While we breathe, toxic fumes and particles (debris) produced by the combustion of fuel, enter into the lungs. Since these particles are as small as 1/5 of the human hair, they reach and penetrate deep into the lungs.

Also, other substances, such as arsenic, benzene, formaldehyde and nickel penetrate the lung. These substances may cause cell mutations which may lead to cancer. It is a fact that prolonged exposure to automobile smoke relates directly to the probability to be affected by any form of cancer.

On the other hand, automobile smoke has also "immediate" effects, such as irritation of the eyes, nose, throat and lungs. It may cause coughing, headaches, dizziness and vomiting. Studies conducted with volunteers showed that emissions of diesel engines have made allergic people even more sensitive to their allergens, such as dust and flowers, and have increased the number of asthma crises in asthmatic persons!

I - What are the most affected groups/age groups?

Exposure to fumes and particles produced by engines is an occupational disease for people being exposed for a long time, such as truck drivers, railroad workers and miners. Furthermore, harmful health effects are observed also in the general population, which faces lower levels of pollution compared to the categories of occupational diseases.

Another group that is affected by these pollutant factors are also the

tjera ndotëse. Ekspozimi ndaj gazeve të makinave është i lidhur me sëmundshmëri më të shpeshtë në fëmijëri.

I - Cili do të ishte propozimi juaj për këtë fenomen?

Duke qenë se në pjesën më të madhe ndotja e ambientit në Shqipëri shkaktohet nga emetimet e makinave në qarkullim, veprimtaritë ndërtuese, vatrat e zjarrit në qendrat urbane për eliminimin e mbetjeve dhe emetimet industriale, edhe nisma për të përmirësuar gjendjen duhet të prekë këta faktorë ndotës.

Për sa i përket makinave, një nga problemet kryesore ngelen motorët me naftë dhe mosha e tyre, ku rreth 90% e tyre kanë mbi 9 vjet punë. Këto lloj motorësh prodhojnë deri në 10 herë më shumë tym dhe "mbetje" sesa motorët e rinj, të cilët kanë detyrim ligjor të përmbushin normat më të fundit të emetimeve nga vendet prodhuese. Një aspekt tjetër është cilësia e karburantit. Karburantet që përdoren në Shqipëri kanë përmbajtje të lartë squfuri dhe plumbi, të palejueshme për t'u përdorur në vendet e tjera evropiane.

Veprimtaritë ndërtuese kanë gjithashtu një impakt të rëndësishëm në ndotjen e ajrit, prandaj zbatimi rigoroz i legjislacionit në fuqi për minimizimin e të tilla vatrave ndotëse do të ishte një hap i parë në drejtimin e duhur.

Për sa i përket faktorit tjetër që është zjarri, duhet gjendur një mënyrë për të adresuar me përparësi zjarrvënien e hapur si metodë për eliminimin e mbetjeve urbane.

Shtimi i gjelbërimit është një tjetër element që ka një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në cilësinë e ajrit.

I - Faleminderit për informacionin e dobishëm dhe kohën tuaj.

children. Children's lungs are still developing and are therefore more sensitive to smoke and other pollutant particles compared to lungs of the adults. Exposure to automobile fumes is associated with more frequent morbidity in childhood.

I - What would be your proposal for this phenomenon?

Considering that most of the environmental pollution in Albania is caused by emissions of automobiles in circulation, construction activities, outbreaks of fire in urban centres in order to eliminate waste and industrial emissions, the initiatives on the improvement of the situation should affect these polluting factors.

Speaking of the automobiles, one of the main problems relates with diesel engines and their age, where about 90% of them have operated for more than 9 years. These types of engines produce up to 10 times more smoke and "waste" than new engines, the latter being subject to legal obligations to meet the latest standards of emissions from the manufacturing countries. Another aspect is the quality of the fuel. The fuel used in Albania has a high content of sulphur and lead, impermissible for use in other European countries.

Construction activities also have a significant impact on air pollution; therefore rigorous enforcement of existing legislation in minimizing such polluting sources would be the first step towards the right direction.

Regarding the fire, as the other factor, priority should be given to finding a method to address the open fires as a means to eliminate waste.

Adding green areas is another element which has a direct positive impact on air quality.

I – Thank you for the useful information and for your time.

Marjola Gurma
Drejtoresh e Grupit Financiar të Porsche-s në Shqipëri / Head of Porsche Finance Group Albania

MERRNI MAKINËN QË DËSHIRONI
GET THE CAR EASILY

Porsche Bank është një bankë lider në tregun e financimit të makinave në Austri dhe në Evropën Juglindore. Të dhënat nga tregu tregojnë se Porsche Bank Group financon një në pesë makina në tregjet ku ai ofron shërbimet e tij financiare. Anëtarët e Porsche Group po punojnë vazhdimisht për të përmirësuar kushtet e financimit dhe për t'i përshtatur paketat e tyre sipas nevojave të klientëve.

Porsche Bank is a leader in car-financing market in Austria and Southeastern Europe. Market data shows that Porsche Bank Group finances every fifth vehicle in the markets where it provides its financial services. Porsche Group members are continuously working on upgrading terms of financing and adjusting its packages to the clients' needs.

Si rezultat i kësaj filozofie, me kalimin e viteve Porsche Bank Group ka arritur të zërë një pozicion lider në të gjitha vendet ku ai ushtron aktivitetin e tij. Porsche Finance Group Albania ka si përparësi përgjigjen ndaj kërkesave specifike të klientëve dhe garantimin e kushteve më të mira dhe më të sigurta në sferën e financimit. Ky është qëllimi ynë dhe ne investojmë të gjitha njohuritë dhe ekspertizën tonë për ta arritur këtë qëllim. Kemi besim të plotë se kjo qasje do të shpërblehet me pozicionin që meriton në treg.

Porsche Finance Group Albania përbëhet nga dy kompani: Porsche Leasing dhe Porsche Mobility. Objektivi yne kryesor është që t'i ofrojmë klientëve tanë zgjidhjet optimale për blerjen e makinave nëpërmjet leasing-ut financiar (qirasë financiare) ose dhënies me qira të makinave VW, Audi, Seat, Škoda, Porsche dhe Weltauto.

Për herë të parë, klientet kanë mundësinë të zgjedhin sipas kërkesave dhe nevojave të tyre specifike produktin e plotë duke nisur me zgjedhjen e modeleve të markave të grupit tonë e deri te produkti financiar, duke i siguruar një proces të lehtë dhe të shpejtë aplikimi dhe miratimi. Kjo nënkupton më pak kohë të të nevojshme nga klienti dhe efikasitet për të gjithë procesin, gjë që cilëson, një nga avantazhet tona konkuruese.

Po kështu, parametrat tanë standardë që nisin me normën e interesit, e cila është më e ulëta që ofrohet sot në shqipëri në tregun e leasing-ut për automjete, është një tjetër avantazh konkurrues që ne prezantojmë në treg.

Duke patur gjithmonë në vëmendje klientin, jemi në kërkim të vazhdueshëm të krijimit të produkteve të reja financiare dhe përmirësimit të vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve. Falë kushteve konkurruese dhe përvojës shumë të mirë në nivel grupi, ne ofrojmë elementët e nevojshme për krijimin e një marrëdhënie afatgjatë dhe cilësore me klientët tanë.

Në Shqipëri, leasing-u përdoret më së shumti për automjetet – leasing për veturat. Që prej krijimit të shoqërisë së parë të leasing-ut në tregun shqiptar e deri në ditët e sotme, një pjesë e konsiderueshme e të gjithë portofolit në të gjitha shoqëritë e leasing-ut, e zë leasing-u për automjetet (për veturat dhe makinat tregtare).

Krahasuar me shtetet e tjera të rajonit, leasing-u i automjeteve në Shqipëri (ashtu si dhe në çdo segment tjetër) është ende në proces zhvillimi, prandaj potencialet për rritje janë të konsiderueshme. Njëkohësisht, mundësitë e mjeteve financiare në dispozicion të kompanive dhe individëve për blerjen e makinave janë të rëndësishme, dhe ne, duhet të punojmë për ta realizuar këtë qëllim nëpërmjet ruajtjes së të gjitha avantazheve që ofron industria e leasing-ut (fleksibilitet, shpejtësi dhe thjeshtësi në përmirësimin e kushteve të financimit).

Porsche Finance Group Albania, në më pak se një vit që operon në treg, arriti të pozicionohet brenda një kohe shumë të shkurtër si një partner i çmueshëm, i mirë dhe i besueshëm në financim. Në fund te muajit Nëntor, u prezantua me ofertën për normën e interest më e ulët në treg prej 4.5%, shoqëruar edhe me mbulimin e kostove të siguracionit për klientët tanë.

Viti i ri 2014 pritet të jetë plot sfida për ne, me lajme të mira dhe mundësi financimi atraktive për klientët, kështu që përfitojmë nga rasti t'u urojmë të gjithë lexuesve, klientëve dhe partnerëve në punën tonë, Gëzuar Krishtlindjen dhe një vit të ri 2014 të mbarë e të begatë!!!

As a result of this philosophy, Porsche Bank Group has reserved a lead position over the years in all of its countries. Porsche Finance Group Albania has a priority to respond to clients' specific demands, as well as to secure the best and safest conditions in the financing domain. That is our goal and we invest all of our knowledge and expertise to achieve this objective. We are confident that this approach will be awarded with an adequate position in the market.

Porsche Finance group Albania consists of two companies: Porsche Leasing and Porsche Mobility. The main task of these two companies is to provide to the clients with the most optimal solutions for car purchase by way of financial leasing or rental of VW, Audi, Seat, Škoda, Porsche and Weltauto.

Our competitive advantages will be to provide for the first time in the same moment full range of product to the client according specific demands and needs, starting by selecting our group brand models up to the financial product, easy and fast application and approval process. This means less time for the client and efficiency for the whole process.

Competitive standards parameters starting from interest rate that is the lower communicated today in leasing market, is another competitive advantage that we are presenting in market.

Proactive access in creating new finance products as well as continues improvement of providing services, best experience in group level, represents modality for development of long term quality partner relationship, between client and leasing company.

In Albania, leasing is most frequently attached to leasing of vehicles – car leasing. Ever since the first leasing company was founded on domestic market up to these days, an important part of entire portfolio of all leasing companies, represents leasing of the vehicles (passengers and commercials).

Leasing of vehicles in Albania, (as in all other segments), comparing to countries in the region, is still in developing process. This means that the potentials for growth are significant. Possibilities of placement means to companies and private persons for purchasing vehicles are significant and we should work on its realization through maintaining all advantages that leasing industry offers now (flexibility, speed and simplicity in financing improvement).

Porsche Finance Group Albania is working on the market for less than one year, and in this time we managed to position as recognizable, good and reliable partner in financing. Action conditions that we offered as during the Fair of end of November and sill running '4.50% interest rate, support on Casco expenses for a certain period, helped us to gain attention and trust of the clients.

The New Year 2014 will be full of challenges for us and good news and attractive financing possibilities for the clients, therefore I take the opportunity to wish to all readers, clients and our business partners Marry Christmas and a good and prosperous 2014!!!

Mirë se vini në “Business Class”

Welcome to “Business Class”

Po është e mundur. Është e mundur të ndërtohet një makinë e cila përmbush në 360 gradë pritshmëritë e drejtuesit dhe pasagjerit. Një makinë e cila ofron të gjithë fuqinë që të nevojitet në çdo situatë rruge, por duke qenë e përmbajtur në normën e emetimeve dhe konsumit. Një makinë që tërheq vëmendje, por edhe të mbulon në një tis misteri duke ju veçuar në hapësirën tuaj personale. Një makinë e qëndrueshme, por edhe e zhdërvjellët në drejtim. Një makinë unike në drejtim dhe mahnitëse në pamje.

Audi A8 është jo thjesht simboli i shtëpisë gjermane të makinave Audi, por është njëkohësisht edhe një ikonë e teknologjisë më të mirë gjermane.

Gjenerata e fundit e modelit Audi A8 ka pësuar përmirësime të mëtejshme në versionin “face lift”. “Audi A8 facelift” u prezantua në panairin e makinave në Frankfurt 2013 në muajin shtator dhe pritet të vijë në tregun shqiptar në janar 2014.

Ishte e vështirë të përmirësohej më tej një makinë si A8, një makinë e cila ka fituar shumë çmime ndërkombëtare si: T3 Gadget Award – në Angli, çmimi për integrimin e teknologjisë së re “geo-positioning”; çmimin për aplikimin në masë të madhe të aluminit në shasi, si dhe shumë çmime të tjera. Megjithatë, modeli i ri mbart disa tipare të cilat e bëjnë më të dukshëm, më teknologjik dhe më të sigurt.

Dritat kryesore LED janë rikompozuar dhe ndryshimi ka prekur edhe grilën e radiatorit. Në pjesën e pasme makina është pajisur me tuba të rinj shkarkimi të kromuar të cilët janë rikonceptuar për më tepër dinamikë.

Motori 3.0 TDI me 201 kf është hequr nga prodhimi për t’i lënë vend motorëve të tjerë më të fuqishëm. Të gjitha modelet A8 vijnë të pajisura me sistemin Quattro në seri ku përjashtim bën vetëm Audi A8 Hybrid, i cili shfrytëzon dy rrotat e para aktive.

Fuqia është rritur ndërkohë që emetimet janë zvogëluar edhe më tej duke u luhatur ndërmjet 155-169 g/km.

Yes it is possible. It is possible to build a car which entirely meets the driver’s and passenger’s expectations. A car which gives you all the power you need in all road conditions, but also limiting the rate of emissions and consumption. A car which can turns heads, but also embraces you into a veil of mystery, putting you in your own private surroundings. A sustainable but yet a versatile car when it comes to driving. A car unique in driving and stunning in looks.

Audi A8 is not just a symbol of the German home of Audi cars, but also an icon of Germany’s best technology.

The latest generation of the Audi A8 model has undergone further improvements in “face lift” version. “Audi A8 facelift” has made its debut at the Frankfurt Motor Show in September 2013 and is expected to enter the Albanian market in January 2014.

It was hard to further improve a car like the A8, a car which has won many international awards, such as: T3 Gadget Award – in England, the award for the integration of the new “geo-positioning” technology, the award on the mass application of aluminium in the chassis, along with many other awards. However, the new model carries several features which make it more visible, more technologic and safer.

LED headlights are recomposed and the change has also affected the radiator grille. The back part of the car is equipped with new chrome exhaust pipes, which are redesigned to increase dynamics.

3.0 TDI 201 HP engine has been put off production to make room for other more powerful engines. All A8 models are equipped with standard Quattro system apart from Audi A8 Hybrid which uses the front-wheel drive.

The power has been increased and the emissions have been further reduced, fluctuating between 155 to 169 g/km.

When we speak about the empowerment of engines it is worth mentioning the 4.2 diesel engine, which now improves from 345 hp

Kur flasim për fuqizim të motorëve vlen të përmendet motori 4.2 me naftë, i cili nga 345 kf arrin tashmë në 380 kf – një diferencë e ndjeshme kjo në situatat kur ju duhet më tepër fuqi.

Por nëse doni t'i jepni një karakter më sportiv udhëtimit tuaj, atëherë Audi S8 është zgjedhja e përkryer. Motori i fuqishëm V8 me 520 kf përshpejton nga 0 në 100 për 4,2 sekonda duke përcjellë në timon një shpirt të vërtetë garash.

Në brendësi ky model ka shumë për të ofruar. Sedilje opsionale me ventilim dhe masazh, sedilje të pasme të lëvizshme, mbështetëse këmbe me regjistrim elektrik dhe klimatizatori me katër zona janë vetëm disa nga veçoritë e anëtarit më të ri të familjes A8.

Për sa i përket sigurisë në udhëtim, Audi A8 ndër të tjera përmban sistemin e ruajtjes së korsisë, kamera parkimi 360 gradë, pasqyrim të navigatorit dhe shpejtësisë në xhamin e shoferit, kamera për ambiente të errëta, si dhe shumë më tepër.

Ky model dhe modelet e tjera Audi mund të provohen në sallonin e kompanisë Porsche Albania.

to 380 hp - a significant difference in situations where you need more power.

But if you want to give a more sporty character to your trip, then Audi S8 is the perfect choice. The powerful V8 520 HP engine accelerates from 0 to 100 in 4.2 seconds, conveying a real racing spirit on the wheel.

The interior of this model has much to offer. Optional ventilated and massaging seats, adjustable rear seats, a powered footrest and four step air conditioning are only some of the features of the newest member of the A8 family.

Speaking of travelling safely, Audi A8 also includes lane assist, 360-degree parking cameras, head-up display for the driver, night vision camera and much more.

This model and other Audi models may be tested at Porsche Albania showroom.

Golf, një variant interesant

Golf, an interesting variant

Familja “Golf” kompletohet tashmë me modelin më të ri “Golf Variant”. Ky model i konceptuar për familjet bazohet në një platformë të ngjashme me atë të “Golf VII” me pjesën e portobagazhit të shtuar për më tepër hapësirë. Në këtë mënyrë është arritur një kursim peshe prej 105 kg në krahasim me gjeneratat e kaluara.

“Dieta” ka ulur tashmë jo thjesht peshën e makinës, por edhe konsumet me afërsisht 15%, duke rritur në anën tjetër kapacitetin e ngarkesës me afërsisht 100 litra (nga 505 litra në 605 litra kapacitetin minimal dhe nga 1495 në 1620 atë maksimal). Një tjetër aspekt që vlen për t’u përmendur tek ky model është edhe shtimi i elementeve dhe i sistemeve të sigurisë aktive në udhëtim.

Ndërmjet pajisjeve një vëmendje të veçantë i është kushtuar sistemit XDS+, sistemi i vetëbllokimit diferencial i gjeneratës së re. Ndërkohë që për të pasuruar përvojën në udhëtim, Volkswagen ka shtuar si pajisje opsionale kontrollin dinamik të shasisë (Dynamic Chassis Control), i cili i mundëson drejtuesit të përshtatë reagimin e makinës.

“Golf” family is now complete with the new Golf Variant model. This model designed for families is based on a platform similar to that of Golf VII, with the addition of the trunk to provide more space. Thus, the new model saves 105 kg of weight compared to the previous generation models.

The “diet” has reduced not only the weight of the car, but also the consumption by approximately 15%, increasing on the other hand the load capacity with approximately 100 litres (505 litres to 605 litres as minimum capacity and 1495 liters to 1620 litres as maximum capacity). Another aspect of this model which is worth mentioning is the addition of active elements and safety systems for the journey.

Amongst other devices, special attention was given to XDS+ differential lock system of the new generation. In addition, Volkswagen has added as optional equipment the dynamic chassis control (DCC) in order to enrich the travelling experience, which allows the drivers to adjust driving response.

"Golf Variant" mund të porositet duke përzgjedhur një nga 10 motorë të ndryshëm (5 benzine dhe 5 nafte) me një rendiment që shkon nga 85 në 150 kuaj-fuqi. Gjithashtu, ndërmjet pajisjeve standarde vlejnë të theksohen sistemi Start&Stop, Multi-Collision Braking (sistemi që frenon makinën për të shmangur përplasje të tjera në rast aksidenti), si dhe ai i dallimit të lodhjes së drejtuesit, sisteme të cilët përmirësojnë dukshëm konsumin dhe sigurinë në udhëtim.

"Golf Variant" can be ordered by selecting one of the 10 different engines (five petrol and five diesel engines) with an output ranging from 85 to 150 HP. In addition, among the standard equipment it is worth highlighting Start & Stop, Multi-Collision BRAKING system (the system which applies the brakes to prevent subsequent impacts when a vehicle has been involved in an accident), and the Driver Fatigue Detection system, which altogether improve consumption and travel safety significantly.



Portobagazhi i modelit "Golf Variant" është bërë më multifunksional me elemente të ndryshme, si p.sh. rrjetat ndarëse dhe hapësira e ngarkesës e rregullueshme në lartësi. Sediljet e pasme mund të ulen tashmë direkt nga pas makinës.

Ky model është 456 cm dhe disponohet në paketat e mëposhtme të pajisjeve: Trendline, Comfortline dhe Highline. Niveli i parë i pajisjeve përfshin në seri 7 airbag-ë, pasqyra të jashtme me rregullim elektrik, ESP, klimatizator, xhama elektrikë para dhe pas, sedilje shoferi e rregullueshme në lartësi, frena dore elektromekanike, si dhe tregues të presionit të gomave.

Siguria aktive. Ndërmjet pajisjeve të sigurisë më të përparuara në seri ekziston mundësia për shtimin e elementeve shtesë si: PreCrash, Front Assist me City Emergency Braking, Lane Assist, Adaptive Cruise Control, Road Sign Recognition.

VW Golf Variant ripërcakton standardin e makinave familjare.

The trunk of Golf Variant model has improved its multi-functionality with different elements, such as the space dividing nets and the adjustable height cargo space. The rear seats can now be folded straight from the back of the car.

This model is 456 cm long and is available in the following packages of equipment: Trendline, Comfortline and Highline. The first level of standard equipment includes 7 airbags, electrically-operated external mirrors, ESP, air conditioning, front and back power windows, height-adjustable driver's seat, electromechanical handbrake, and a tire pressure indicator.

Active safety. Among the most advanced standard safety equipment, there is a possibility of adding additional elements such as: PreCrash, Front Assist with City Emergency Braking, Lane Assist, Adaptive Cruise Control and Road Sign Recognition.

VW Golf Variant redefines the standard for family cars.

Car myths

E vërtetë apo e gabuar? - Nëse mendoni se dini gjithçka rreth makinave, bëni këtë test të shkurtër. Tetë pohime dhe të vërtetat që fshihen pas tyre.

True or false? - If you think you know everything about cars, take this quick test. Eight statements and the truths behind them.

një litër benzinë është më e rëndë se një litër ujë

E gabuar. Edhe pse benzina ka shumë energji, ajo gjithsesi ka dendësi më të ulët se uji dhe është më e lehtë; kjo është edhe arsyeja pse ajo pluskon mbi sipërfaqen e pellgjeve. Në temperaturën 15 gradë Celsius, një litër peshon midis 720 g dhe 775 g. Një litër naftë peshon midis 820 g dhe 845 g. Uji, nga ana tjetër, peshon thuajse një kilogram.

onelitre of petrol is heavier than one litre of water

False. Although petrol has a lot of energy, it still has a lower density than water and is lighter, which is why it floats on the top of puddles. At 15 degrees Celsus, a litre weighs between 720 g and 775 g. A litre of diesel weighs between 820 g and 845 g. Water, on the other hand, weighs almost a kilogram.

shiu rrit konsumin

E vërtetë. Shiu ka ndikim tepër të madh në dinamikën e drejtimit të mjetit dhe për rrjedhojë në konsumin e tij. Kjo ndodh për shkak se gomat duhet të përhapin shtresën e ujit në rrugë, njësoj si anija në ujë. Për kapërcimin e kësaj rezistence të ujit nevojitet shumë fuqi e për rrjedhojë konsumohet më shumë karburant. Situata të tilla mund të rrisin konsumin e karburantit deri në 30 për qind.

rain increases consumption

True. Rain has an enormous impact on the physics of driving and thus on the vehicle's consumption. This is because the tires have to displace the layer of water on the road, similar to a ship on water. Overcoming this water resistance takes a lot of power and thus uses up fuel. Such driving situations may increase fuel consumption byup to 30 percent.

në një makinë kabriolet qëndroni të thatë edhe kur bie shi

E vërtetë, por vetëm nëse i jepni mjaft shpejt makinës. Ekspertët nga seriali televiziv "Myth Busters" e kanë provuar këtë. Dhe rekomandojnë që ta mbuloni makinën. Sepse edhe në makinën e tyre të provës, me xham të përparmë me këndshumë të pjerrët, pasagjerët nuk qëndruan të thatë deri në momentin që makina arriti shpejtësinë 150 km/orë – shpejtësi e cila nuk rekomandohet në mot me shi!

in a cabriolet you stay dry even when it's raining

True, but only if you are driving fast enough. The experts from the TV series Myth Busters put this to the test. And they recommend that you put the top up. Because even in their test car with a sharply raked windscreen the passengers didn't remain dry until the car reached speeds of 150 km/h-a speed that isn't recommended when it's raining!

SIGAL

UNIQA

UNIQA GROUP AUSTRIA

Shqipëri
Kosovë
Maqedoni

QENDRA E BIZNESIT SIGAL
Blv. "Zogu I", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: (+355) 4 2233 308
E-mail: info@sigal.com.al
www.sigal.com.al

Nëse dëshironi të siguroheni, ka vetëm 1 emër...

SIGAL ju mbron gjatë udhëtimit tuaj!

PËR MBROJTJE MAKSIMALE SIGURONI AUTOMJETIN TUAJ ME:

- ☑ SIGURIMET E DETYRUESHME TPL, KARTON JESHIL DHE KUFITARE
- ☑ KASKO
- ☑ MINIKASKO
- ☑ GPS

The hybrid future.

E ardhmja e makinave hibride

Disa vjet më parë fjala hibrid përdorej për të demonstruar dimensionin futurist të një kompanie, si diçka që mund të dukej bukur në sallonet e prezantimit dhe për të qetësuar presionin në rritje nga pjesa e shoqërisë e ndërgjegjshme për mjedisin. U hodhën në treg dhe u reklamuan modele prototipe që nuk ishin menduar kurrë për t'u prodhuar në seri. Çdo prodhues makine do të ishte dakord se teknologjia e nevojshme dhe niveli i sofistikimit ishin thjesht të pamundura.

Por realiteti ndryshoi shpejt. Zhvillimet e mëdha në teknologji filluan të shtronin rrugën drejt një të ardhmeje për modelet hibride. Filluan të akordoheshin fonde më të mëdha në kërkimin dhe zhvillimin e modeleve hibride, në zhvillimet e infrastrukturës dhe dalëngadalë po evoluonte një ndryshim i paradigmës në vizionin i shihte lëndët djegëse fosile si të vetmet lëndë djegëse "të arsyeshme" për të ushqyer ekonomitë e uritura të lëvizjes në mbarë botën.

Numri i makinave hibride në qarkullim është ende më i ulët se 5% e numrit në total, kështu që krijohet përshtypja sikur nuk janë shumë makina, por demografia po ndryshon.

Kryetari i Bordit Drejtues të Volkswagen AG, Prof. Dr. h.c. mult. Martin Winterkorn, deklaroi: "- Po elektrifikojmë të gjitha klaset e makinave, 14 modele me drejtim elektrik ose hibrid deri në vitin 2014". Këto makina janë përmirësuar jo vetëm në drejtim të performancës, por edhe të pamjes së tyre dhe të kostos. Këto zhvillime po tërheqin tashmë njerëzit e të gjitha llojeve që përfshin që nga përqafuesit e parë të teknologjive e deri tek ambientalistët dhe drejtuesit ekzekutivë.

Por çfarë forme do t'i japë kjo e ardhme mënyrës së operimit të shërbimeve të makinave tradicionale?

Në planin afatshkurtër, për sa kohë ofiçinat e riparimit të makinave kryejnë shumë detyra që luhaten midis trajnimit dhe shërbimit, gjithçka do të jetë në rregull. Në planin afatgjatë, atyre u duhet të punojnë shumë për të qëndruar koherent me të gjitha novacionet e reja që përfshihen nën kofanon e makinës. Deri në vitin 2020, ka shumë mundësi që këta teknikë makinash të jenë po aq të aftë në përdorimin e teknologjisë sa edhe programuesit më të mirë të kompjuterëve në ditët e sotme!

Ndërkohë që elektriciteti zë vendin kryesor në makinat hibride, profili i inxhinierëve apo mekanikëve pas pajisjeve testuese do të duhet të modifikohet në elektromekanik dhe inxhinier mekatronik. Bateritë me tension të lartë në makinat hibride variojnë nga 144 në 330 volt DC, ku disa prodhues shkojnë në një energji deri 650 volt AC dhe kjo do të kërkojë që për ndreqjen e problemeve në makinën tuaj të punojë vetëm personel i kualifikuar.

Makinat e ardhshme hibride përdorin më të mirën e teknologjisë në dispozicion për të krijuar makina që do të joshin një grup të madh njerëzish. Rritja më e madhe në blerjen dhe prodhimin e makinave hibride ka qenë në modelet sedan, SUV dhe coupe, veçanërisht në versionet hibride të makinave ekzistuese.

Me rritjen e çmimit të karburantit, shumë prodhues makinash po rrisin prodhimin dhe zgjedhjen e makinave hibride. A ekziston mundësia që edhe makinat hibride të dalin jashtë përdorimit nëse teknologjia na lejon të heqim dorë nga karburanti dhe të përdorim burime energjie alternative të pastra, si p.sh. hidrogjeni ose etanoli? Këtë vetëm koha do ta tregojë...

A few years ago the word 'hybrid' was used to shape a futuristic dimension of a company, something that would look good on presentation halls and to pacify the increasing pressure of the environmentally aware niche of the society. Prototype models that would have never been intended for mass production were launched and advertised. Every car producer would have agreed that technology needed and the level of sophistication simply wasn't available.

But the reality soon changed. The massive developments in technology started paving the road to a hybrid future. Larger budget pie slices were committed to hybrid R&D, infrastructure developments and a paradigm shift in the vision that saw fossil fuel as the only 'reasonable' fuel to feed the motion hungry economies around the world, was evolving.

Hybrid vehicles on the road is still less than 5%, so it may not seem like very many cars, but the demographic is changing.

Chairman of the Board of Management of Volkswagen AG, Prof. Dr. h.c. mult. Martin Winterkorn announced: "We are electrifying all vehicle classes, 14 models with electric or hybrid drive by 2014". These vehicles have improved not only in performance, but also in their appearance and cost. These developments are now attracting people of all types ranging from early adopters to environmentalists and executives.

But how will this future shape the way traditional car services would operate?

In the short term, as long as car repair shops multitask between training and service they will be ok. In the long term, they will have to work hard to stay up to date with all the new innovations under the hood. By 2020, it is quite possible that these auto technicians may have to be just as tech savvy as today's best computer programmers!

As the electricity takes the main role in the hybrid cars the profile of the engineer or mechanics behind the testing tools will have to shift to electro-mechanics and mechatronic engineers. The high voltage batteries in hybrid vehicles range from 144 to 330 volts DC with some manufactures reaching to 650 volt AC power and this will require only qualified personnel to handle your car problems.

These future hybrid cars utilize the best in our available technology to create cars that will appeal to a vast array of people. The greatest increase in purchasing and production of hybrid cars has been in sedans, coupes, and SUVs, particularly in hybrid versions of cars that already exist.

With gas prices going up, many car manufacturers are increasing their production and selection of hybrid cars. Is it possible that hybrid cars will also become obsolete if technology allows us to move away from gasoline and into purely alternative energy sources like hydrogen or ethanol? Only time will tell...

Das WeltAuto.

Intervistë me Fabian Jungitsch, drejtor i përgjithshëm në Porsche Albania.
An interview with Fabian Jungnitsch, general manager at Porsche Albania.

I. U bënë dy vjet nga fillimi i projektit Weltauto. Sa i suksesshëm mund të konsiderohet ai?

Platforma Weltauto u prezantua për të testuar mundësitë tona në tregun e makinave të përdorura si edhe për të përmbushur nevojat e klientëve tanë për lëvizshmëri. Ne vendosëm si objektiv të sillnim një zgjidhje të strukturuar në këtë treg makinash. Dy vite pas fillimit, them me bindje se kjo nismë ka funksionuar. Numri i makinave të shitura nëpërmjet platformës Weltauto jo vetëm ka kapur por edhe ka tejkaluar pritshmëritë tona.

I. Përse duhet që një klient potencial i makinave të përdorura të vijë tek ju, në vend që ti drejtohet tregut informal?

Si një kompani e specializuar në shitjen e makinave ne kemi mundësi t'u ofrojmë klientëve tanë makina cilësore dhe të mirëmbajtura. Çdo makina e shitur i nënshtrohet disa kontrolleve dhe i bëhen të gjitha riparimet e nevojshme përpara se të ofrohet për t'u shitur. Shumë makina, për të përfitojnë nga garancia Weltauto deri në 1 vit që është edhe një përfitim i prekshëm për të gjithë klientët tanë. Në websitin tonë Weltauto ne prezantojmë gamën e produkteve me një përshkrim të detajuar dhe fotografi të makinës në mënyrë që klientët të mund të zgjedhin edhe para se të vijnë në sallonin tonë. Ne kemi një konsulent të dedikuar shitjeje i cili ofron të gjithë informacion e nevojshëm për të përgjedhur makinën tuaj. Ky website përditohet vazhdimisht dhe gama e ofertave rritet në mënyrë të vazhdueshme.

I. Porsche Albania ka qënë shumë aktive në lobimin që është bërë ndaj makinave të përdorura. A ka një pozicionim të kundërt nëse marrim parasysh projektin Weltauto.

Ne po lobojmë për strukturimin e tregut të makinave të përdorura në Shqipëri pasi me sistemin aktual tregtarët zyrtarë të makinave janë tërësisht të diskriminuar. Ne duam të shesim makina të volitshme financiarisht të sigurta, si dhe të përmirësojmë në të njëjtën kohë ambientin. Platforma Weltauto kombinon më së miri kërkesat si të qytetarëve ashtu edhe ato të qeverisë. Integrimi në Bashkimin Europian do ta bëjë të domosdoshëm riformatimin e këtij tregu.

I. Çfarë pritet në 2014?

Ne do të vazhdojmë të përforcojmë markën Weltauto e cila shpejt do të ndryshojë në paraqitje. Ne jemi të gatshëm të shtojmë më tej biznesin e makinave të përdorura në sajë të marrëveshjeve me klientët tanë. Megjithatë shpejtësia e këtij proçesi varet tërësisht nga vendim-marrja politike. Ne jemi gati dhe optimist për zhvillimet që do të ndodhin.

I. Faleminderit për kohën

Faleminderit.

I. It has been two years since the launch of the Weltauto project. How successful was it?

The Weltauto platform was launched to test the used car market and as a tool to meet our client's needs for mobility. We set an objective to provide a structured solution for those who were interested in this category of vehicles. Two years from the start, I can say that we were right. The numbers sold through Weltauto in 2013 have really exceeded our expectations.

I. Why should a used car potential buyer choose Weltauto rather than to purchase from the private Market?

As a professional and licensed company in the automotive business we have the ability to offer to the customer well maintained, high quality used vehicles. Every vehicle sold used to our customers undergoes a serious service check and all necessary repairs are done before the car is even offered. Many cars will even be equipped with a Weltauto used car warranty up to 1 year which is an additional benefit for the customer. On our Weltauto website we show the range of products we offer with detailed technical descriptions and pictures so the customer can preselect before even coming to our showroom. There a dedicated sales consultant awaits you to support you in all necessary steps to receive the vehicle of your choice. The website is updated regularly and the offer range is constantly increased.

I. Porsche Albania has been quite active in the lobbying for a formalization and professionalization of the Used car market in Albania. How does this correspond with the Weltauto project?

We are lobbying for the regulation of the used car market in Albania as with the current legislation and taxation systems in place professional car retailers are practically excluded from the Market. We want to participate and sell more qualitative, environmentally friendly and safe vehicles on reasonable fiscal and economic bases. The Weltauto brand can accomplish all of that and satisfy customers and the Albanian governments needs at the same time. Also towards the EU association this would be a significant and necessary political step that has to be undertaken.

I. What to expect in 2014?

We will continue to strengthen the Weltauto brand that soon will change its corporate identity. We are very much willing to increase our used vehicles activities through trade in and active purchases but the speed of this development is entirely depending on future political decisions. We are ready and hope for improvements to come soon.

I. Thank you for your time.

Thank you.

SEAT al Sol

Seat inauguron impiantin më të madh me energji diellore në industrinë e makinave

Seat inaugurates the largest solar plant of the automotive industry

Projekti “SEAT al Sol” është plotësisht funksional. Ky projekt i zhvilluar së bashku me kompaninë Gestamp Solar, siguron energji të pastër në një masë të madhe në të njëjtin vend konsumi (parimi i prodhimit të decentralizuar të energjisë). Kursimet mjedisore arritën në 7000 tonë CO2 në vit, vlerë kjo e barabartë me 8,5-fishin e dioksidit të karbonit që thith çdo vit Central Park në Nju Jork. Fabrika ka një fuqi nominale rreth 11 MW dhe pik fuqie rreth 12 MW, të gjeneruar nga 15 milion kWh në vit, e cila përbën 25% të energjisë vjetore të nevojshme për prodhimin e modelit të ri SEAT Leon, me zero ndikim në mjedis.

Jürgen Stackmann deklaroi se “SEAT Martorell feston 20 vjetorin e tij dhe projekti “SEAT al Sol” është një shembull i qartë i progresit të fabrikës, e cila sapo ka fituar edhe çmimin “Lean Production” për cilësinë dhe efiçencën që ka në proceset e prodhimit.” Lidhur me këtë, ai ka theksuar rëndësinë që marka i jep përfshirjes së çështjeve të mjedisit në strategjinë e biznesit të saj: “SEAT është një kompani e përgjegjshme dhe respektimi i mjedisit është një nga prioritetet tona. Ne kemi impiantin më të madh me energji diellore në industrinë e makinave, një fakt që dëshmon se angazhimi ynë në mbrojtjen e mjedisit është konkret.”

The project SEAT al Sol is fully operational. Thisproject which has been developed together with Gestamp Solar, provides clean energy on a large scale in the same place of consumption (principle of distributed generation). The environmental savings achieved is of 7,000 tonnes of CO2 per year, equivalent to 8.5 times the carbon dioxide absorbed annually by the Central Park in New York. The facilities have nearly 11 MW of nominal power and 12 MW peak power generated by 15 million kWh per year, 25% of the annual energy required to manufacture the new SEAT Leon, with zero environmental impact.

Jürgen Stackmann has stated that “SEAT Martorell celebrates its 20th anniversary and the project SEAT al Sol is a clear example of the evolution of the factory which has also just received the Lean Production Award for the quality and efficiency applied in its production processes.” In this regard, he has highlighted the importance of the environmental commitment of the brand in its business strategy: “SEAT is a responsible company and the respect for the environment is one of our priorities. We have the largest solar plant on the automotive industry, a fact that proves that our commitment is real.”

SEAT Ibiza
CUPRA

Esenca e SEAT
The Essence of SEAT

Ibiza CUPRA shfaq në formën më të pastër esencën e markës SEAT. Një dizajn mahnitës, performancë mbreslënëse dhe teknologjia më e lartë vijnë sëbashku tek Ibiza CUPRA për të formësuar modelin më dinamik në kategorinë e tij. Në sajë të përmasave kompakte, nivelit të lartë të funksionalitetit, Ibiza Cupra është një makinë sa emocionuese aq edhe dinamike. Performanca – e shkëlqyer. Me një përshpejtim nga 0 në 100 km/h në vetëm 6.9 sekonda dhe një shpejtësi maksimale prej 228 km/h – kjo makinë është jashtëzakonisht efiçiente, ku konsumi mesatar arrin në 5.9 litra/100 km.

The new Ibiza CUPRA displays the essence of the SEAT brand in its purest form – a stunning design, amazing performance and state-of-the-art technology come together in the Ibiza CUPRA to create the most dynamic package in its class. With its compact format and high level of functionality, the Ibiza CUPRA is an enjoyable, dynamic car for everyday use. Performance is scintillating – accelerating from zero to 100 km/h in just 6.9 seconds and on to a top speed of 228 km/h – and yet exceptionally efficient, ëith average fuel consumption of just 5.9 litres/100 km.

8 vjet në lëvizje
8 years onthe move

Ka motorë sportivë, elegantë, komikë, të markave të njohura ose jo, të mëdhenj, agresivë, të vegjël, praktikë, të rëndë, të shpejtë dhe me një mori tiparesh të tjera, por asnjëri prej tyre nuk i përafrohet motorit për të cilit duam të shkruajmë sot.

Sot duam të përshkruajmë një motor të veçantë, i cili nuk punon me 4 kohë apo me karburant, nuk ka pistona as injektorë, por është gjithsesi shumë i fuqishëm. Është një motor i veçantë, i cili bëhet më i fortë sa më tepër kalon koha dhe sot pas 8 vitesh është më i gjallë dhe zhdërvjellët se kurrë më parë. Sot duam të flasim për "motorin" Porsche Albania.

"Ndezur" 8 vjet më parë, ky motor ka ndryshuar përgjithmonë tregun e makinave të reja në vend dhe qasjen ndaj klientit shqiptar. Përvoja më e mirë austriake, markat më në zë të grupit Volkswagen dhe energjia vendase kanë qenë karburanti më i mirë për të në këtë udhëtim.

Rrugëtimin e tij e ka filluar me dy markat Audi dhe SEAT, por me vrullin dhe energjinë e tij shumë shpejt përfshiu në familje edhe

There exist sportive, stylish, and comic engines of well-known and less known brands, big, aggressive, small, practical, heavy, fast, and with a lot more features, but none of them compare to the engine that we are writing about today.

Today, we want to describe a particular engine, which is not a 4-stroke or fuel engine, and it has no pistons or injectors but, nevertheless, it is very powerful. It is a very special engine that becomes stronger as time goes by and, today, after 8 years it is more vivid and versatile than ever before. We are going to write about the Porsche Albania "engine" today.

'Starting' 8 years ago, this engine has permanently changed the new car market in the country and the approach to Albanian customers. The best Austrian experience along with the most prominent brands of the Volkswagen Group and the local power have all been its best fuel along this journey.

Its journey began with the two brands Audi and SEAT, but with its vigor and energy very soon it also included SKODA, Volkswagen

marka të tjera, si SKODA, Volkswagen makina tregtare dhe së fundmi edhe Volkswagen makina pasagjerësh. Por rruga nuk ka qenë gjithmonë e shtruar. Sfidat e mëdha dhe të vogla kanë ngadalësuar jo rrallë herë ritmin e tij dhe të tregut të makinave të reja në Shqipëri.

Për të festuar, për të kujtuar, por gjithashtu edhe për të parë përpara, Porsche Albania zhvilloi në "vendparkimin" e zakonshëm një aktivitet të pazakontë. Panairi i 8 vjetorit i organizuar në Pallatin e Kongreseve në datat 17-20 tetor, ishte vendi ideal ku modelet e makinave të ekspozuara u shoqëruan me oferta të rëndësishme dhe jo thjesht joshëse. Financimi i plotë i makinave, mbulimi 100% i interesit të financimit, si dhe kushtet më fleksibël për qiranë afatgjatë – ngacmuan, tërhoqën dhe bindën një numër të madh klientësh për të përfituar nga këto oferta.

Edhe pse ka 8 vjet në udhëtim, rruga përpara për këtë motor është e gjatë dhe entuziazmuese.

Gëzuar ditëlindjen Porsche Albania!

commercial vehicles and, recently, Volkswagen passenger cars. But then again, the road has not always been paved; large and small challenges have often slowed its pace as well as the pace of the new car market in Albania.

Porsche Albania held, in the usual 'parking lot', an unusual activity in order to celebrate, remember, and then to look ahead again. The 8th Anniversary Fair organized at the Palace of Congresses on October 17-20, was the ideal place where the exhibited car models were associated with significant and not simply tempting offers. The full funding of the vehicle, the 100% coverage of financing interest, and also more flexible terms for long-term leasing stirred, attracted, and persuaded a large number of clients to take advantage of these excellent offers.

Although it has been on this drive for 8 years, the way forward for this engine is still long and exciting.

Happy birthday Porsche Albania!

Panairi **Klik Expo** Trade Fair

Një udhëtim në të shkuarën.
A journey down the memory lane.

Në Nëntor të 2013 Porsche Albania mori pjesë në panairin e përvitshëm Klik Ekspo. Pjesmarrja këtë vit ish konceptuar si një udhëtim në vitet kur markat tona kanë hyrë zyrtarisht në treg.

5 modele VW Golf të gjeneratave të ndryshme u ekspozuan, ku secili sillte një ngjarje në Shqipërinë e atij viti kur ky model ish prodhuar për herë të parë.

Kjo mundësi u shfrytëzua gjithashtu për të prezantuar disa modele të reja si: Audi A3 Sedan, ŠKODA ŠKODA Yeti facelift, ŠKODA Rapid Spaceback, ŠKODA Superb facelift.

In November 2013 Porsche Albania took part at the Klik Expo annual trade fair. The participation motive this year was a journey through the years that our brands have officially been represented in the Albanian market.

5 models of VW Golf of different generations, were displayed each recalling a particular event in Albania that coincided with the birth year of that model

This opportunity was also used to introduce the new models that were brought for this activity Audi A3 Sedan, ŠKODA Yeti facelift, ŠKODA Rapid Spaceback, ŠKODA Superb facelift.

Caddy – gjithmonë i pari.

Vendi i parë në: 'KEP Transporter of the Year', 'All- wheel Vehicle of the Year' por edhe fituesi i 'Best commecial Vehicle 2012', 'Flottenauto of the Year' si fituesi i 'Flottina Awards' flasin qartë për këtë model. Caddy® me 30 vite përvojë dhe 330 versione është makina e përkryer për heronjtë e përditshëm. Sepse heronjtë dinë të zgjedhin një partner tek i cili mund të mbështeten 365 ditët e vitit.
Caddy. Vendos vazhdimisht standarde të reja!

Makina Tregtare

Për informacion mbi ofertën na vizitoni në dy sallonet tona në Classic Sh.p.k dhe Porsche Albania ose në: +355 (0) 69 20 57 234.

SIMPLY CLEVER

ŠKODA

Konsumi i kombinuar i karburantit dhe emetimet e kombinuara të CO2 për Spaceback janë: 3.8-5.8 l/100 km, 99.134g/km.

ŠKODA Rapid Spaceback. Hapësira është ndjesi! Sot për 10,480 Euro.

Hyni në ŠKODA Rapid Spacebag dhe gjëja e parë që do t'ju bjerë në sy është hapësira dhe ndricimi në brendësi. Tavani panoramik opsional së bashku me dritaret e pasme krijojnë këtë ndjesi të veçantë. Edhe pse është modeli i parë 'hatchbag' nga ŠKODA, Rapid Spacebag mbart tiparet më të mira të markës ku hapësira në brendësi është një prej tyre. Për të përjetuar ndjesinë ka vetëm një mënyrë! Një xhiro prove!

www.skoda-auto.al

facebook.al/skodaalb

Për më tepër na vizitoni në tre sallonet tona:

PORSCHE ALBANIA
Autostrada Tiranë-Durrës km. 3, Tiranë,

E.T.T Group Auto Sh.p.k
Kthesa e Viroit, Gjirokastër
Cel : +355 (0) 69 40 52 594

KOSTANDIN GROUP
Rruga Nacionale Shkodër-Tiranë